

PROGRAMI VJETOR I INSTRUMENTIT TË PARA-ANËTARËSIMIT 2012

**MBËSHTETJE PËR INSTITUCIONET E KOSOVËS NË FUSHËN E
MBROJTJES SË
TË DHËNAVE PERSONALE**

Numri i projektit: Europe Aid/133806/C/SER/XK

Numri i kontratës: 2013/333-753

**MEMORANDUM MBI GJENDJEN AKTUALE NË LIDHJE ME PAKON E
REFORMAVE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE TË BE-SË**

NORA G. FORGACS

31/01/2016

Aktiviteti 1.1.2./8.



Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian



Ky projekt është implementuar nga
konsorciumi i udhëhequr nga Hulla & Co.
Human Dynamics KG (AU)



Ky projekt është financiar
nga Bashkimi Evropian

**MBËSHTETJE PËR INSTITUCIONET E KOSOVËS NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE
PERSONALE**
(Europe Aid/133806/C/SER/XK, SC № 2013/333-753)



Ky projekt është Implementuar nga
Human Dynamics KG

Projekt i BE-së “Mbështetje për institucionet e Kosovës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”

Europe Aid/133806/C/SER/XK

Kontratë e Komisionit Evropian nr. 2013/333-753

Mbështetje për institucionet e Kosovës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

MEMORANDUM I 8-të MBI GJENDJEN AKTUALE NË LIDHJE ME PAKON E REFORMAVE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE TË BE-së

Prishtinë, Kosovë, 31/01/2016



Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian

**MBËSHTETJE PËR INSTITUCIONET E KOSOVËS NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE
PERSONALE**
(Europe Aid/133806/C/SER/XK, SC № 2013/333-753)



Ky projekt është Implementuar nga
Human Dynamics KG

Ky raport është përgatitur nga Konsorciumi Human Dynamics KG. Të gjeturat, konkluzionet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë vetëm ato të Konsorciumit dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të konsiderohen si pasqyrim i politikave apo opinioneve të Komisionit Evropian.



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

Ky projekt është Implementuar nga Human Dynamics KG

Siç e kemi theksuar në *Memorandumin tonë të 7-të të datës 30 tetor 2015* mbi gjendjen aktuale të reformës për mbrojtje të të dhënave të BE-së, disa nga avancimet më të rëndësishme ishin bërë gjatë periudhës së fundit raportuese:

- i. Negociatat trepalëshe ndërmjet Parlamentit, Këshillit dhe Komitetit kanë vazhduar
- ii. Ministrat në Këshillin e Drejtësisë kanë arritur një marrëveshje të përgjithshme mbi Direktivën e BE-së për Mbrojtje të të Dhënave *për sektorin e policinë dhe të drejtësisë penale*
- iii. Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPS) ka publikuar rekomandimet e tij për nenet e Rregullores së përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR)
- iv. EDPS-ja ka nxjerr rekomandime për Direktivën mbi mbrojtjen e të dhënave në sektorët e policisë dhe drejtësisë

Në periudhën aktuale raportuese (31 tetor - 13 janar) përmirësimet më të rëndësishme që kanë ndodhur janë paraqitur më poshtë:

- i. Më 15 dhjetor 2015, Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni Evropian kanë arritur marrëveshje mbi rregullat e reja për mbrojtjen e të dhënave
 - ii. Marrëveshja është mirëpritur nga Këshilli Evropian (17-18 Dhjetor)
 - iii. Më 17 dhjetor, në një takim të jashtëzakonshëm, Komisioni i Parlamentit Evropian për Liri Civile, Drejtësi dhe Punë të Brendshme (LIBE) miratoi tekstet e dakorduara gjatë dialogut trepalësh.¹
 - iv. Më 18 dhjetor 2015, Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm (Coreper) konfirmoi tekstet e kompromisit të dakorduar me Parlamentin Evropian për reformën e mbrojtjes së të dhënave.
 - v. Është lëshuar deklarata mbi planin e veprimit për vitin 2016 mbi zbatimin e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave
- i. Më 15 dhjetor 2015, Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni Evropian kanë arritur marrëveshje mbi rregullat e reja për mbrojtjen e të dhënave**

Parlamenti dhe Këshilli Evropian kanë arritur marrëveshje mbi reformën e mbrojtjes së të dhënave të propozuara nga Komisioni. Kjo reformë është një hap thelbësor për forcimin e të drejtave themelore të qytetarëve në epokën digjitale dhe për të lehtësuar biznesin duke thjeshtësuar rregullat për kompanitë në Tregun e Vetëm Digjital. Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave përcakton rregullat e përbashkëta të privatësisë përgjatë Evropës dhe krijon autoritet të fortë zbatues. Ligji do të jetë plotësisht i zbatueshëm për rreth dy vite.²

¹ Sot, EDPS mirëpret rezultatin e votimit nga Komisioni i Parlamentit Evropian për Liri Civile, Drejtësi dhe Punë të Brendshme (LIBE) të pakos së reformës për mbrojtjen e të dhënave. BE-ja edhe njëherë është duke vendosur standardet për legjislacion modern dhe të fuqishëm për mbrojtjen e të dhënave. Shih: <https://secure.edps.europa.eu/EDPSWEB/edps/EDPS/Pressnews/News/N2015>

² <https://epic.org/2015/12/european-institutions-conclude.html>



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

MBËSHËTETJE PËR INSTITUCIONET E KOSOVËS NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
(Europe Aid/133806/C/SER/XK, SC № 2013/333-753)



Ky projekt është Implementuar nga Human Dynamics KG

Reforma përbëhet prej dy instrumenteve:

- **Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave** do t'i mundësojë njerëzve që t'i kontrollojnë më mirë të dhënat e tyre personale.
- **Direktiva për Mbrojtjen e të Dhënave** për sektorin e policisë dhe të drejtësisë penale do të sigurojë që të dhënat e viktimave, dëshmitarëve dhe të dyshuarve të krimeve, të mbrohen në mënyrë të rregullt në kuadër të një hetimi penal apo veprimi të autoriteteve të zbatimit të ligjit.³

Aspektet më të rëndësishme të reformave kanë për synim t'i adresojnë çështjet e ndryshme të paraqitura më poshtë:

a) E drejta themelore për qytetarët

Reforma do t'i lejoj njerëzit të rimarrin kontrollin e të dhënave të tyre personale. Dy të tretat e Evropianëve (67%), sipas një sondazhi të fundit të Eurobarometer, kanë deklaruar se janë të shqetësuar pasi që nuk kanë kontroll të plotë mbi informacionet që i ofrojnë në internet. Shtatë nga dhjetë Evropianë janë të shqetësuar për përdorimin e mundshëm të informacionit të shpalosur nga ana e kompanive. Reforma e mbrojtjes së të dhënave do të forcojë të drejtën për mbrojtjen e të dhënave, e cila është një e drejtë themelore në BE, dhe i mundëson atyre të kenë besim në vende që i ofrojnë të dhënat e tyre personale.⁴

Rregullat e reja i adresojnë këto shqetësime duke forcuar të drejtat ekzistuese dhe duke fuqizuar individët me më shumë kontroll mbi të dhënat e tyre personale. Më së shumti, këto përfshijnë:

- **qasje më të lehtë në të dhënat tuaja:** individët do të kenë më shumë informata mbi atë se si përpunohen të dhënat e tyre, dhe ky informacion duhet të jetë në dispozicion në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme;
- **të drejtën për portativitet të të dhënave:** do të jetë më i lehtë transferimi i të dhënave tuaja personale në mes të ofruesve të shërbimeve;
- **"të drejtën e sqaruar për t'u harruar":** kur ju nuk dëshironi që të dhënat tuaja të përpunohen dhe kur nuk ka arsye legjitime për t'i mbajtur ato, ato të dhëna do të fshihen;
- **të drejtën për të ditur nëse të dhënat tuaja janë komprometuar (hakuar):** Për shembull, kompanitë dhe organizatat duhet të njoftojnë autoritetin mbikëqyrës kombëtar për shkeljet e rënda të të dhënave sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që përdoruesit të mund të ndërmarrin masat e duhura.⁵

b) Rregulla të qarta moderne për biznese

Përmes unifikimit të rregullave të Evropës për mbrojtjen e të dhënave, ligjvënësit janë duke krijuar mundësi për bizneset dhe janë duke promovuar inovacionin.

³ http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-6321_en.htm

⁴ http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-6321_en.htm

⁵ http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-6321_en.htm



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

Ky projekt është Implementuar nga Human Dynamics KG

- **Një kontinent, një ligj:** Rregullorja do të krijojë një grup të vetëm rregullash të cilat do ta bëjnë më të lehtë dhe më të lirë për kompanitë që të zhvillojnë biznes në BE.
- **Zyra pritëse:** Bizneset duhet të merren me një autoritet të vetëm mbikëqyrës. Kjo është vlerësuar të kursej rreth 2.3 miliardë € në vit.
- **Rregullat Evropiane në tokën Evropiane** - kompanitë e vendosura jashtë Evropës duhet të aplikojnë të njëjtat rregulla kur ofrojnë shërbime në BE.
- **Qasja e bazuar në rrezik:** rregullat do të anashkalojnë barrën e obligimeve uniforme dhe në vend të saj do t'i përshtatin ato sipas rreziqeve përkatëse.

Rregullat e përshtatshme për inovacion: rregullorja do të garantojë se masat mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave janë vendosur në produkte dhe shërbime që nga fazat më të hershme të zhvillimit (mbrojtja e të dhënave sipas dizajnit). Teknikat miqësore ndaj privatësisë të tilla si pseudonimizimi do të inkurajohen për të mbledhur përfitimet e inovacionit të të dhënave më vëllim të lartë gjatë mbrojtjes së privatësisë.⁶

c) Përfitimet e njëjta për akteret e mëdhenj dhe të vegjël

Reforma e BE-së për mbrojtjen e të dhënave do ti ndihmojë NVM-të që të hyjnë në tregje të reja. Sipas rregullave të reja, NVM-të do të përfitojë nga katër reduktimet në nivel burokratik:

- **Nuk ka më njoftime:** Njoftimet për autoritetet mbikëqyrëse janë formalitet që përfaqësojnë kosto për biznesin prej € 130 milion në vit. Reforma do t'i heqë ato tërësisht.
- **Do të llogaritet çdo qindarkë:** Kur kërkesat për qasje në të dhëna janë haptazi të pabazuara apo të tepruara, NVM-të do të mund të vendosin tarifa për ofrim të qasjes.
- **Zyrtarët për Mbrojtjen e të Dhënave:** NVM-të janë të liruara nga detyrimi për të emëruar një zyrtar për mbrojtje të të dhënave për aq kohë sa përpunimi i të dhënave nuk është veprimtaria e tyre kryesore e biznesit.
- **Vlerësimet e ndikimit:** NVM-të nuk do të jenë të detyruar të kryejnë vlerësim të ndikimit përderisa nuk ka ndonjë rrezik të lartë ⁷

d) Mbrojtja e të dhënave personale në fushën e zbatimit të ligjit

- **Bashkëpunim më i mirë ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit**

Me Direktivën e re të Mbrojtjes së të Dhënave për Autoritetet e Policisë dhe Drejtësisë Penale, autoritetet e zbatimit të ligjit në Shtetet Anëtare të BE-së do të jenë në gjendje të shkëmbejnë informacione të nevojshme për hetime në mënyrë më efikase dhe efektive, të përmirësojnë bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit dhe krimeve tjera të rënda në Evropë.

Direktiva e Mbrojtjes së të Dhënave për Autoritetet e Policisë dhe Drejtësisë Penale merr parasysh nevojat e veçanta të zbatimit të ligjit, respekton traditat e ndryshme ligjore në Shtetet Anëtare dhe është në përputhje të plotë me Kartën e të Drejtave Themelore.

- **Mbrojtja më e mirë e të dhënave të qytetarëve**

⁶ http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-6321_en.htm

⁷ http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-6321_en.htm



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

Ky projekt është Implementuar nga Human Dynamics KG

Të dhënat personale të individëve do të mbrohen më mirë kur përpunohen për qëllime të zbatimit të ligjit, duke përfshirë parandalimin e krimit. Ajo direktive do t'i mbrojë të gjithë - pa marrë parasysh nëse janë viktime, kriminel apo dëshmitar. Të gjitha përpunimet e zbatimit të ligjit në Union duhet të përpunohen me parimet e nevojës, proporcionalitetit dhe ligjshmërisë, me masa të duhura mbrojtëse për individët. Mbikëqyrja sigurohet nga autoritetet e pavarura kombëtare për mbrojtjen e të dhënave, si dhe duhet të ofrohen mjete efektive juridike.

Direktiva e Mbrojtjes së të Dhënave për Autoritetet e Policisë dhe Drejtësisë Penale ofron rregulla të qarta për transferimin e të dhënave personale nga autoritetet e zbatimit të ligjit jashtë BE-së, për të siguruar që niveli i mbrojtjes së individëve që është i garantuar në BE, të mos jetë i dëmtuar.

i. Marrëveshja ishte mirëpritur nga Këshilli Evropian

Në mbledhjet e Këshillit Evropian të mbajtura me 17-18 dhjetor, u mirëpritën marrëveshjet duke u vlerësuar si një hap i rëndësishëm para në zbatimin e Strategjisë për Tregun Unik Digjital. Në vijim të nismave të Komisionit për forcimin dhe thellimin e Tregut Unik, Këshilli Evropian:⁸

a) Bën thirrje për zbatimin e udhërrëfyesit të dhënë për Strategjinë e Tregut Unik në mënyrë që të arrihet një treg më i gjerë dhe i drejtë i Tregut Unik për mallra dhe shërbime në të gjitha vendet kyçe;

b) Fton, në interes të konsumatorëve dhe industrisë, të gjitha institucionet e BE-së të përshpejtojnë zbatimin e Strategjisë së Tregut Unik Digjital; mirëpret marrëveshjen e arritur në pakon e mbrojtjes së të dhënave si një hap të madh përpara;⁹

iii. Me 17 dhjetor, në një takim të jashtëzakonshëm Komisioni i Parlamentit Evropian i Lirive Civile, Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme (LIBE) mbështeten tekstet e miratuara në dialogun trepalësh.¹⁰

EDPS mirëpriti rezultatin e votimit të Komisionit Evropian Parlamentar për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme (LIBE) për pakon e reformës për mbrojtjen e të dhënave, duke theksuar se: BE-ja edhe një herë vendosi standard për legjislacion modern dhe të fuqishëm për mbrojtjen e të dhënave.¹¹

Iv. Me 18 dhjetor 2015, Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm (Coreper) konfirmoi tekstet e kompromisit të dakorduar me Parlamentin Evropian mbi reformën për mbrojtjen e të dhënave.¹²

⁸ Takimi i Këshillit Evropian (17 dhe 18 dhjetor 2015) – Konkluzionet, <http://www.consilium.europa.eu/en/meetings/european-council/2015/12/17-18/>

⁹ Takimi i Këshillit Evropian (17 dhe 18 dhjetor 2015) – Konkluzionet, <http://www.consilium.europa.eu/en/meetings/european-council/2015/12/17-18/>

¹⁰ <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/12/18-data-protection/>

¹¹ Shihni: <https://secure.edps.europa.eu/EDPSWEB/edps/EDPS/Pressnews/News/N2015>

¹² <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/12/18-data-protection/>



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

MBËSHITETJE PËR INSTITUCIONET E KOSOVËS NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
(Europe Aid/133806/C/SER/XX, SC № 2013/333-753)



Ky projekt është Implementuar nga Human Dynamics KG

v.) Është lëshuar deklarata për planin e veprimit të vitit 2016 për zbatimin e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave

Në javën e dytë të muajit shkurt të vitit 2016, Pala Punuese 29¹³ zyrtarisht ka lëshuar deklaratën e saj mbi planin e veprimit të vitit 2016 për zbatimin e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave, duke theksuar katër prioritetet gjatë këtij ndryshimi të madh rregullator.¹⁴

Plani i veprimit përfshin katër veprimet kryesore si në vijim: 1) vendosja e strukturës së EDPB në aspektin e administratës (p.sh. TI, burimet njerëzore, marrëveshjet për shërbime dhe buxhetin), 2) Përgatitjen e një zyre pritëse (one stop shop) dhe mekanizmin e qëndrueshmërisë, 3) Lëshimin e udhëzimeve për kontrolluesit dhe përpunuesit dhe 4) Komunikimi rreth EDPB/GDPR.¹⁵ Aktivitetet për çdo veprim të përmendur më sipër janë përmbledhur në vijim:

1) Vendosja e strukturës së EDPB në aspektin e administratës (p.sh. TI, burimet njerëzore, marrëveshjet për shërbime dhe buxhetin)

Një task forcë WP29-EDPB është krijuar së bashku me Kryesuesin, Zëvendës Kryesuesit dhe Mbikëqyrësin Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPS), ndërsa sekretariati do të formohet nga EDPS sipas udhëzimeve të Kryesuesit të EDPB. Element kyç do të jetë zhvillimi i sistemeve të TI-së për EDPB-në në kontekst të zyrës pritëse. Task forca gjithashtu do të punojë edhe për burimet njerëzore, implikimet e buxhetit si dhe në rregulloren e ardhshme të punës së EDPB.

2) Krijimi i zyrës pritëse dhe mekanizmi i qëndrueshmërisë

Zhvillimet në disa blloqe të GDPR të tilla si: → caktimin e autoritetit kryesor për mbrojtjen e të dhënave → zyrën pritëse për bashkëpunim zbatues → mekanizmin e qëndrueshmërisë së EDPB.

3) Lëshimi i udhëzimeve për kontrolluesit dhe përpunuesit

Subjektet me prioritet janë përzgjedhur nga WP29 për të ofruar udhëzime ose procese për të ndihmuar dhe shoqëruar kontrolluesit dhe përpunuesit që të përgatiten për hyrje në fuqi. Ata do të ndërlihen me temat e mëposhtme:

- E drejtë e re mbi portativitetin
- Nocioni i rrezikut të lartë, dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mbrojtjen e të Dhënave (DPIA)
- Certifikimi

¹³ Neni 29 për Grupin Punues të Mbrojtjes së të Dhënave u krijua sipas Direktivës 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 24 tetor 1995 mbi mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla. Ka status këshillimor dhe vepron në mënyrë të pavarur. Neni 29 për Grupin Punues të Mbrojtjes së të Dhënave përbëhet nga: një përfaqësues i autoritetit mbikëqyrës i caktuar nga çdo vend i BE-së; një përfaqësues të autoritetit të krijuar për institucionet dhe organet e BE-së; një përfaqësues të Komisionit Evropian.

¹⁴ <https://iapp.org/news/a/article-29-working-party-lays-out-gdpr-action-plan/>

¹⁵ <https://iapp.org/news/a/article-29-working-party-lays-out-gdpr-action-plan/>



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

MBËSHËTETJE PËR INSTITUCIONET E KOSOVËS NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
(Europe Aid/133806/C/SER/XK, SC № 2013/333-753)



Ky projekt është Implementuar nga Human Dynamics KG

- Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave

4) Komunikimi rreth EDPB/GDPR

Është shumë e rëndësishme që të behet këtë organ, një organ të ri ligjor të BE-së që veçse është i dukshëm dhe i identifikueshëm si aktor kyç, legjitimiteti i të cilit buron nga AMDH. → Krijimi i një mjeti për komunikim online → Fuqizimi i marrëdhënieve me agjencitë e institucioneve të BE-së ose me grupet tjera mbikëqyrëse → Pjesëmarrja në ngjarje të jashtme për promovimin e modelit të ri të qeverisjes.

Pas rishikimit ligjor-gjuhësor të teksteve, ato do të dorëzohen për miratim tek Këshilli dhe më pas tek Parlamenti. Rregullorja dhe direktiva kanë të ngjarë që të hyjnë në fuqi në pranverë të vitit 2018.¹⁶

Rregullorja dhe Direktiva do të duhet të aprovohen nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli. Rregullat e reja do të bëhen të zbatueshme pas dy vitesh. Komisioni do të punojë ngushtë me autoritetet për mbrojtjen e të dhënave të Shteteve Anëtare në mënyrë që të sigurohet zbatim uniform i rregullave të reja. Gjatë fazës dy vjeçare të tranzicionit, Komisioni do të informojë qytetarët për të drejtat e tyre dhe si dhe kompanitë për detyrimet e tyre.¹⁷

Dr. Nora G. Forgacs

Eksperte për mbrojtjen e të dhënave /Eksperte Kyçe

¹⁶ <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/12/18-data-protection/>

¹⁷ http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-6321_en.htm